



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 426/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                 |            |
|-----------------|------------|
| Evis Shurdha    | Kryetar    |
| Leonard Gremshi | Zv/Kryetar |
| Hektor Balluku  | Anëtar     |
| Kleves Janku    | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 25.06.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-62014-04-11-2018, me objekt: *Loti I “Blerje dokumentacioni shkollor (regjistra, amza, deftesa, certifikata, pulla me helogram) për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”*, me fond limit 7,933,459 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve te Përqendruara.

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Inter Logistic*” sh.p.k nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

**Ankimues:**

“Adel Co” shpk  
Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Zogu i Zi Tiranë

“Inter Logistic” shpk  
Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës, Rruga dytësore km 9, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Ministria e Brëndshme, Agjencia e Blerjeve te Përqendruara.  
Adresa: Sheshi “Skëndërbej” Nr. 3, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:****I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “Adel Co” shpk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Operatori ekonomik ankimues “Interlogistic” shpk nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” shpk.

**II**

## Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.04.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-62014-04-11-2018, me objekt: Loti I “Blerje dokumentacioni shkollor (regjistra, amza, deftesa, certifikata, pulla me helogram) për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, me fond limit 7,933,459 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2 . Në datën 07.05.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 21.05.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

|                           |                  |              |
|---------------------------|------------------|--------------|
| 1. “Ekspo Sistem”         | pa dokumentacion | skualifikuar |
| 2. “ALB Tipografia”       | 6,187,900        | skualifikuar |
| 3. “Adel Co”              | 6,408,206.35     | skualifikuar |
| 4. “Interlogistic”        | 6,438,943.30     | skualifikuar |
| 5. “Kristalina-KH”        | 6,769,998        | kualifikuar  |
| 6. “Shtypshkronja Morava” | 7,220,819        | kualifikuar  |
| 7. “Albdesign PSP”        | 7,250,914        | skualifikuar |
| 8. “Rama Graf”            | 7,764,105        | skualifikuar |
| 9. “Dynamic X”            | 7,796,200        | skualifikuar |

II.4. Në datën 21.05.2018, operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen se:

1) Nuk plotëson kapacitetin ekonomik dhe financiar të përcaktuar në pikën 1, të seksionit 2.2 të kriterëve të vecanta për kualifikim, të Shtojcës 9 të DST, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur kopje të certifikuar të bilancit të vitit 2017 të paraqitur pranë autoriteteve tatimore përkatëse.

2) Nuk plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.3 të kriterëve të vecanta për kualifikim, të Shtojcës 9 të DST, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore shoqëruar me Listpagesat për muajin mars 2018, duke mos vërtetuar se ka të punësuar minimumi 4 (katër) punonjës të siguruar për këtë muaj.

3) Nuk plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 3, të seksionit 2.3 të kriterëve të vecanta për kualifikim, të Shtojcës 9 të DST, pasi ofertuesi nuk ka vërtetuar pasjen e minimumi një makinë shtypi me format 50X70 cm, duke mos shoqëruar kontratën e qiramarrjes me faturën e blerjes/faturën e zhdoganimit të makinerisë, ku të përcaktohet qartë lloji i saj. Sqarojmë se në kontratën e qeramarrjes nuk është përcaktuar qartë lloji i makinerisë (modeli) dhe as në faturën e zhdoganimit nuk përcaktohet qartë as lloji as formati i makinerisë (shënuar më shkrim dore formati 70x100).

II.4.1. Në datën 25.05.2018, operatori ekonomik “Adel Co” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

*Shoqëria “Adel Co” shpk mori pjesë në tenderin me objekt Loti I “Blerje dokumentacioni shkollorë (regjistra, amza, deftesa, certifikata, pulla me hologram) për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, më datë 07.05.2018.*

*Në datë 21.05.2018 me vlerësimin e tenderit përmes sistemit elektronik të APP-së. Pas shqyrtimit të rënditjes dhe kualifikimit të operatorëve, mendojmë se në fazën e vlersimit institucioni juaj ka treguar papërgjegjësi në vlersimin e ofertave.*

*Sipas këtij vlersimi, shoqëria “Adel Co” shpk është skualifikuar me arsyet e rënditura si më poshtë:*

*1) Nuk plotëson kapacitetin ekonomik dhe financiar të përcaktuar në pikën 1, të seksionit 2.2 të kriterëve të vecanta për kualifikim, të Shtojcës 9 të DST, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur kopje të certifikuar të bilancit të vitit 2017 të paraqitur pranë autoriteteve tatimore përkatëse.*

*Përsa i perket pikës së parë, pra pretendimit të autoritetit tuaj kontraktor për mos paraqitjen e bilancit të vitit 2017, ju bejme me dije se kriteri është kufizues përse i perket mundësive të pjesëmarrjes. Në lidhje me bilancin e vitit 2017 nuk duhet të kërkohej si taksativ nga ana juaj pasi, sipas ligjit ka afat deri me datë 31 mars të kësaj viti për mbylljen e bilancit. Aq më tepër që, deklarimi nga tatimet mund të zgjase deri në muajin qershor. Të gjitha komunikimet shkresore që behen deri në daljen e bilancit janë vetëm burokraci deri në formosjen dhe vulosjen e këtij bilanci nga administrata tatimore, duke krijuar edhe vonesa. Meqenëse data e tenderit ishte shumë pranë afatit për procedurat e bilancit, koha për paraqitjen e raportit të auditit, pjesë integrale dhe e pandashme e bilancit nuk mjaftonte. Mbi të gjitha, i perket Administratës Tatimore të vleresojë dhe të konfirmojë për dokumentacionin lidhur me këtë çështje. Kërkesa për këtë bilanc ishte thjesht një burokraci që shërben si pengesë për operatorët ekonomikë që kanë interes për të qenë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.*

*Në nenin 46, pika 1, germa “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese” Përsa me siper, mendojmë se skualifikimi i shoqërisë “Adel CO” sh.p.k, është i padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin “Për Prokurimin Publik”.*

*Përsa i përket pikës së dytë: Se “Nuk plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.3 të kriterëve të vecanta, të shtojcës 9 të DST pasi nuk ka paraqitur Vertetim nga Administrata Tatimore shoqëruar me Listpagesat për muajin Mars 2018, duke mos vertetuar se ka të paktën minimumi 4 punonjës të siguruar”. Përsa i perket pikës së dytë, pra mos përmbushjes së kriterit për deklarimin e numrit minimal 4 persona të siguruar, duke mos paraqitur Vertetim nga Administrata Tatimore shoqëruar me Listpagesat për muajin Mars 2018, ne mendojmë se kjo nuk përben arsye për skualifikim.*

*Institucioni juaj nuk ka marre parasysh faktin qe kapacitetet prodhuese te shoqerise tone jane shume te larta (vertetuar nga dokumentat e paraqitura). Gjithashtu, duhet marre parasysh qe ne ditet e sotme, nje pjese e madhe e makinerive jane automatike dhe jo manuale, dhe qe perdorimi i forces punetore nuk eshte i permasave sic mendon AK. Numri i punonjsve mund te pesoje ulje, por ne menyre graduale duke mos prekur mundesite per realizim me sukses te kontratave. Perderisa nje operator mund te vertetoje nje numer shume me te madh punonjesish nga ai i kerkuar, (4 punonjes) per nje periudhe me te madhe se nje vit, konkretisht nga janari- 2017- shkurt- 2018 sic vertetoi shoqeria )jone, mosparaqitja e vertetimit per muajin mars nuk tregon asnje gje per kapacitetet teknike te shoqerise.*

*Përsa i përket pikës së tretës se: “Nuk ploteson kapacitetin teknik te percaktuar ne DST pasi nuk ka vertetuar pasjen e minimumi nje maldne shtypi me format 50x70 cm, duke mos shoqeruar kontraten e qera marrjes me faturen e blerjes/ faturen e zhdoganimit te makinerise, ku te percaktohet qarte lloji i saj. Sqarojme se ne kontraten e qeramarrjes nuk eshte percaktuar qarte lloji i makinerise (modeli) dhe as ne faturen e zhdoganimit nuk percaktohet qarte as lloji as formati i makinerise (shenuar me shkrim dore formati 70x100)”*

*Persa i perket pikes se trete, per kontraten e qeramarrjes, ju bejme me dije se kjo kontrate ka te gjitha specifikimet e nevojshme, te cilat jane shenuar edhe ne kontrate edhe ne dokumentin e zhdoganimit.*

*- Makineri shtypi*

*- Formati 70x 100*

*5 ngjyra*

*Gjithashtu edhe ne dokumentin e zhdoganimit eshte percaktuar “makineri printimi se bashku me pjeset e saj”. Me poshte eshte shkruar nr. i shasisë dhe deklaruesi ka shkruar “ mak. 5 C”, per te specifikuar makinen me shkrim dore tek pjesa e deklarates. Ne dokumentat e zhdoganimit nuk eshte domosdoshmeri qe te shkruhet specifikisht emri i makinerise. Ne mendojme se ky kriter behet i tepert dhe diskriminues pasi percakton ne menyre taksative menyren sesi duhet te provoje nje operator ekonomik potencial per te marre pjese ne nje procedure prokurimi. Kerkesa kaq specifike perben kufizim i cili eshte ne kundërshtim te hapur me ligjin nr. 9643 date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Ne nenin 46, pika 3 te ketij ligji percaktohet: “Kerkesat per kualifikirn duhet te hartohen ne menyre te tille qe te stimulojne pjesemarrjen e biznesit te vogel dhe te mesem dhe ne çdo rast te jene sipas percaktimeve ne rregullat e prokurimit publik”.*

*Duke njohur rendesine e kesaj makinerie per procesin e punes, sipas sasise dhe grafikut te levrimit, shoqeria “Adel CO” sh.p.k, ka paraqitur kontraten e qerase per makinerine e kerkuar. Ne kushtet kur kjo kontrate nuk sherben per te bindur autoritetin tuaj kontraktor per kapacitetin teknik, ne ju ftojme ne ambientet e shtypshkronjes tone, te kryeni verifikimin ne vend. Ne VKM 914, date 29.12.2014, “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ne nenin 27, pika 3 percaktohet se Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 46 to LPP. Kriteret duhet te jene ne perpjestim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, Autoriteti Kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kritereve”.*

*Persa me siper, kerkojme kualifikimin e shoqerise "Adel CO" sh.p.k, pasi skualifikimi eshte bere ne kundërshtim me ligjin "Per Prokurimin Publik".*

II.4.2. Në datën 30.05.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 535/1 prot i ka kthyer përgjigje palës ankimuese duke vendosur pranimin pjesërishtë të ankesës dhe më konkretisht në lidhje me pretendimin si më poshtë:

*Vlerëson të pa drejtë skualifikimin për arsyen: Nuk ploteson kapacitetin teknik te percaktuar ne piken 2, te seksionit 2.3 te kritereve te vecanta, te shtojces 9 ne DST pasi nuk ka paraqitur Vertetim nga Administrata Tatimore shoqeruar me Listpagesat per muajin Mars 2018, duke mos vertetuar se ka te punesuar minimumi 4 punonjes te siguruar". Nga verifikimi i dokumentacionit për këtë procedurë rezulton se nga ky operator janë dorëzuar listpagesat së bashku me vërtetimet nga administrata tatimore për periudhën Janar 2017- Shkurtë 2018, ku numri i punonjësve i deklaruar në këto listpagesa rezulton të jetë shumë më i madh se ai i kërkuar në dokumentat standarte të tenderit. Në dokumentat e paraqitura nga operatori mungon vërtetimi nga administrata tatimore për numrin e punonjësve dhe listpagesa vetëm për muajin Mars 2018. Sipas ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 53 pika 4, "Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj". Duke mbajtur parasysh vonesat, ngarkesën referuar periudhës në fjalë dhe burokracitë e administratës tatimore, si dhe faktit se listpagesa e operatorit mungon vetëm për një muaj, dhe është e saktë për gjithë muajt e tjerë kërkuar sipas DST-së, gjykojmë që mungesa e vërtetimit tatimor vetëm për muajin mars të cilësohet devijim i vogël sipas referencës ligjore të sipërpërmendur.*

*Sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka vendosur se skualifikimi për pikën e dytë nuk është i drejtë dhe pretendimi i subjektit "Adel Co" shpk për këtë pikë të pranohet.*

II.4.3. Në datën 11.06.2018 operatori ekonomik ankimues "Adel Co" shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit mësipërcituar, me argumentat si më poshtë:

*Persa i perket pikes se pare, pra pretendimit te autoritetit tuaj kontraktor per mos peragjitjen e bilancit te vitit 2017, ju bejme me dije se kriteri eshte kufizues persa i perket mundesive te pjesemarrjes. Ne lidhje me bilancin e vitit 2017 nuk duhet te kerkohet si taksativ nga ana juaj pasi, sipas ligjit ka afat deri me date 31 mars to cdo viti per mbylljen e bilancit. Aq me teper qe, deklarimi nga tatimet mund te zgjase deri ne muajin qershor. Te gjitha komunikimet shkresore qe behen deri ne daljen e bilancit jane vetem burokraci deri ne frmosjen dhe vulosjen e ketij bilanci nga administrata tatimore, duke krijuar edhe vonesa. Meqenese data e tenderit ishte shume prane afatit per procedurat e bilancit, koha per pergatitjen e raportit tr auditit, pjese integrale dhe e pandashme e bilancit nuk mjaftonte. Mbi te gjitha, i perket Administrates Tatimore te vleresoje dhe te konfirmoje per dokumentacionin lidhur kesaj ceshtjeje. Kerkesa per kete bilanc ishte thjesht nje burokraci qe sherben*

si pengese per operatoret ekonomike qe kane interes per te qene pjesemarres ne kete procedure prokurimi.

Ne nenin 46, pika 1, germa "b" te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te keni permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese".

Persa me siper, mendojme se skualifikimi i shoqerise "Adel CO" sh.p.k, eshte i padrejte dhe ne kundersiztim me ligjin "Per Prokurimin Publik".

Përsa i përket pikës së dytë se: "Nuk ploteson kapacitetin teknik te percaktuar ne DST pasi nuk ka vertetuar pasjen e minimumi nje maldne shtypi me format 50x70 cm, duke mos shoqeruar kontraten e qera marrjes me faturen e blerjes/ faturen e zhdoganimit te makinerise, ku te percaktohet qarte lloji i saj. Sqarojme se ne kontraten e qeramarrjes nuk eshte percaktuar qarte lloji i makinerise (modeli) dhe as ne faturen e zhdoganimit nuk percaktohet qarte as lloji as formati i makinerise (shenuar me shkrim dore formati 70x100)"

Persa i perket pikes se trete, per kontraten e qeramarrjes, ju bejme me dije se kjo kontrate ka te gjitha specifikimet e nevojshme, te cilat jane shenuar edhe ne kontrate edhe ne dokumentin e zhdoganimit.

- Makineri shtypi
- Format 70x 100
- 5 ngjyra

Gjithashtu edhe ne dokumentin e zhdoganimit eshte percaktuar "makineri printimi se bashku me pjeset e saj". Me poshte eshte shkruar nr. i shasisse dhe deklaruesi ka shkruar " mak. 5 C", per te specifikuar makinen me shkrim dore tek pjesa e deklarates. Ne dokumentat e zhdoganimit nuk eshte domosdoshtmeri qe te shkruhet specifikisht emri i makinerise. Ne mendojme se ky kriter behet i tepert dhe diskriminues pasi percakton ne menyre taksative menyren sesi duhet te provoje nje operator ekonomik potencial per te marre pjese ne nje procedure prokurimi. Kerkesa kaq specifike perben kufizim i cili eshte ne kundersiztim te hapur me ligjin nr. 9643 date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar. Ne nenin 46, pika 3 te ketij ligji percaktohet: "Kerkesat per kualifikim duhet te hartohen ne menyre te tille qe te stimulojne pjesemarrjen e biznesit te vogel dhe te mesem dhe ne çdo rast te jene sipas percaktimeve ne rregullat e prokurimit publik". Duke njohur rendesine e kesaj makinerie per procesin e punes, sipas sasise dhe grafikut te levrimit, shoqeria "Adel CO" sh.p.k, ka paraqitur kontraten e qerases per makinerine e kerkuar. Ne kushtet kur kjo kontrate nuk sherben per te bindur autoritetin tuaj kontraktor per kapacitetin teknik, ne ju ftojme ne ambientet e shtypshkronjes tone, te kryeni verifikimin ne vend. Ne VKM 914, date 29.12.2014, "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, ne nenin 27, pika 3 percaktohet se Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 46 to LPP. Kriteret duhet te jene ne perpjestim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, Autoriteti Kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kriterëve".

*Persa me siper, kerkojme kualifikimin e shoqerise "Adel CO" sh.p.k, pasi skualifikimi eshte bere ne kundershkrim me ligjin "Per Prokurimin Publik".*

II.5. Në datën 21.05.2018, operatori ekonomik "Interlogistice" sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen se:

*"1) Nuk plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.3 të kriterëve të vecanta për kualifikim, të Shtojcës 9 të DST, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore për muajt tetor 2017 - mars 2018, duke mos vërtetuar se ka të punësuar minimumi 4 (katër) punonjës të siguruar për këtë muaj".*

II.5.1. Në datën 22.05.2018, operatori ekonomik "Interlogistice" shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

*Shoqëria "Interlogistice" shpk pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor "Ministria e Brendshme", më datë 07.05.2018, me objekt "Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi" – Marrëveshje Kuadër – me disa operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara", në të 7 (shtatë) lotet, referuar në klasifikimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë njoftuar në faqen zyrtare të APP më datë 21.05.2018 është njoftuar për refuzimin e ofertës së paraqitur prej saj me arsyen se: "Nuk plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.3 të kriterëve të vecanta për kualifikim, të Shtojcës 9 të DST, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore për muajt tetor 2017 - mars 2018, duke mos vërtetuar se ka të punësuar minimumi 4 (katër) punonjës të siguruar për këtë muaj". "Nuk Plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 3, të seksionit 2.3, të kriterëve të vecanta për kualifikim, të Shtojcës 9 të DST, pasi ofertuesi nuk ka vërtetuar pasjen e minimumi një makinë shtypi me format 50\*70 cm dhe minimumi një makinë qepëse, duke mos shoqëruar kontratën e qirramarjes me faturen e blerjes/faturen e zhdoganimit të makinerisë së shtypit dhe qepese, ku të përcaktohet qartë lloji i tyre".*

*Në mbështetje të nenit 23, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe të pikës 2, të DST, "kapaciteti Teknik", kërkohet shprehimisht që "operatori ekonomik të ketë të punësuar minimumi 4 (katër) punonjës të siguruar për muajt tetor 2017 – mars 2018 vërtetuar me Vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore shoqëruar me list pagesat për muajt mësipërm"*

*Referuar në sa më sipër "Interlogistic" shpk sqaron se ka paraqitur listpagesat për muajet e kërkuar në DST, të marra nga sistemi online i administratës tatimore, ku vërtetohet plotësimi i kriterit të mësipërm. Mosparaqitja e vërtetimit nuk është kusht thelbësor e skualifikues pasi referuar në listpagesat "Interlogistic" shpk ka vërtetuar se ka të punësuar minimumi 4 punonjës të siguruar për periudhën e kërkuar.*

*Në mbështetje të nenit 23, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe të pikës 2, të DST, "Kapaciteti Teknik", kërkohet shprehimisht që:*



*Operatori ekonomik duhet të ketë:*

- *Minimumi një makinë shtypi me format 50\*70;*
- *Minimumi një makinë qepëse;*
- *Minimumi një makinë celefoni;*

*Për të vërtetuar këtë pikë operatori ofertues duhet të parqesë:*

- *Në rast se makineritë janë në pronësi të tij, faturën e blerjes ku të përcaktohet qartë lloji i makinerisë ose faturën e zhdoganimit e të makinerisë ku të përcaktohet qartë lloji i saj.*

*Në rast se makineritë janë marrë me qera të paraqitet akti i qeramarrjes shoqërura me faturën e blerjes ku të përcaktohet qartë lloji i makinerisë ose faturën e zhdoganimit e të makinerisë ku të përcaktohet qartë lloji i saj të qiradhënësit.*

*Referuar sa më sipër “Interlogistic” shpk sqaron se ka parqitur kontratën e qiramarrjes me shoqërinë Inpress shpk, shoqëruar me bilancin e qiradhënësit, në të cilin vërtetohet pronësia e tij për makineritë e kërkuara në DST. Ndaj sa më sipër kërkojmë pranimin e kësaj ankese dhe kualifikimin e ofertës tonë.*

II.5.2. Në datën 28.05.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 526/1 prot i ka kthyer përgjigje palës ankimuese duke vendosur pranimin pjesërishtë të ankesës dhe më konkretisht në lidhje me pretendimin si më poshtë:

*Vlerëson të pa drejtë skualifikimin për arsyen: Nuk Plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 3, të seksionit 2.3, të kriterëve të vecanta për kualifikim, të Shtojcës 9 të DST, pasi ofertuesi nuk ka vërtetuar pasjen e minimumi një makinë shtypi me format 50\*70 cm dhe minimumi një makinë qepëse, duke mos shoqëruar kontratën e qiramarrjes me faturën e blerjes/faturën e zhdoganimit të makinerisë së shtypit dhe qepëse, ku të përcaktohet qartë lloji i tyre”. Operatori ekonomik pretendon se ka paraqitur kontratën e qiramarrjes me shoqërinë “Inpress” shpk, shoqëruar me bilancin e qiradhënësit në të cilin vërtetohet pronësia e tij për makineritë e kërkuara në DST. Në këto kushtë, gjykojmë se pretendimi do të pranohet me argumentimin se makineritë në fjalë janë të pasqyruara në bilancin e firmës “Inpress” shpk, subjekt i cili është palë në kontratë qiradhënie me operatorin ekonomik pjesmarrës në tender. Në kushtet kur këto makineri janë të pasqyruara në bilanc është e vërtetueshme se nuk mund të jenë rregjistruar pa faturë tatimore ose deklaratë zhdoganimi. Në bazë të nenit 53, pika 4 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Shyrtimit të Ankesës e gjykon mungesën e faturës tatimore dhe deklaratës së zhdoganimit nga kompania qiradhënëse, si devijim të vogël nga kriteret teknike në DST. Për arsyet e mësipërme skualifikimi për këtë pikë nuk është i drejtë dhe pretendimi i subjektit “Interlogistic” shpk për këtë pikë pranohet. Në bazë të nenit 63 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenit 78 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Komisioni i Shyrtimit të Ankesave i propozon titullarit rikthimin në KVO, duke theksuar se ky devijim nuk përbën shkak për kualifikimin e operatorit ekonomik, sa kohë mbetet i skualifikuar sipas pikës 1 të këtij vendimi.*

*Bazuar në sa më sipër, konstatojmë se skualifikimi i shoqërisë “Interlogistic” shpk, është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.*

II.5.3. Në datën 13.06.2018 operatori ekonomik ankimues “Interlogistic” shpk, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit mësipërcituar, me argumentat si më poshtë:

*Kërkuesi shoqëria “Interlogistic” shpk, pas publikimit të njoftimit në lidhje me dokumentet e Procedurës së Prokurimit Publik, të shpallur në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) nga Ministria e Brëndshme me objekt “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi” – Marrëveshje Kuadër – me dis aoperatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat deri më 31.12.2018, ka paraqitur ofertën e tij ekonomike e teknike. Kërkuesi shoqëria “Interlogistic” shpk në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) në procedurën e prokurimit të organizuar nga Ministria e Brëndshme dhe sipas kërkesës në DST “Interlogistic” shpk, sqaron se ka paraqitur listpagesat për muajt e kërkuar, të marra nga sistemi online i Administratës Tatimore, ku vërtetohet plotësimi i kriterit të mësipërm. Referuar në klasifikimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë, publikuar në faqen zyrtare të APP-së, “Interlogistic” shpk është njoftuar për refuzimin e ofertës së paraqitur prej tij me arsyen: “Nuk plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.3 të kriterëve të vecanta për kualifikim, të Shtojcës 9 të DST, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore”. Mosparaqitja e vërtetimit nuk është kusht thelbësor e skualifikues, pasi referuar në listpagesat e dorëzuara, “Interlogistic” shpk ka vërtetuar se ka punësuar minimumi 4 punonjës të siguruar për peridhën e kërkuar.*

*Referuar në Ligjin “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe duke pasur në konsideratë se “Interlogistic” shpk, ka plotësuar kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3, të DST kërkojmë pranimin e kësaj ankesë dhe kualifikimin e ofertës së shoqërisë “Interlogistic” shpk si të vlefshme.*

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 526/2 prot., datë 14.04.2018, protokolluar me tonën me nr. 1081/2 datë 19.06.2018, me objekt “Dërgim dokumentacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “[...]Persa i perket pikes se pare, pra pretendimit te autoritetit tuaj kontraktor per mos peragitjen e bilancit te vitit 2017, ju bejme me dije se kriteri eshte kufizues persa i perket mundesive te pjesemarrjes. Ne lidhje me bilancin e vitit 2017 nuk duhet te kerkohet si taksativ nga ana juaj pasi, sipas ligjit ka afat deri me date 31 mars to cdo viti per mbylljen e bilancit. Aq me teper qe, deklarimi nga tatimet mund te zgjase deri ne muajin qershor. Te gjitha komunikimet shkresore qe behen deri ne daljen e bilancit jane vetem

*burokraci deri ne frmosjen dhe vulosjen e ketij bilanci nga administrata tatimore, duke krijuar edhe vonesa. Meqenese data e tenderit ishte shume prane afatit per procedurat e bilancit, koha per pergatitjen e raportit tr auditit, pjese integrale dhe e pandashme e bilancit nuk mjaftonte. Mbi te gjitha, i perket Administrates Tatimore te vleresojte dhe te konfirmoje per dokumentacionin lidhur kesaj ceshtjeje. Kerkesa per kete bilanc ishte thjesht nje burokraci qe sherben si pengese per operoret ekonomike qe kane interes per te qene pjesemarres ne kete procedure prokurimi [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Vecanta për Kualifikim” pika 2.2.1, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve te viteve 2016, 2017 të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Shkresën nr. 40943/1 prot, datë 16.08.2017, nga Drejtoria e Shërbimit dhe Rregjistrimit të Tatimpaguesve “Konfirmim Bilanci 2016”.*
- *Raport Auditi për bilancin e vitit 2016*
- *Raport Auditi për bilancin e vitit 2107*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gëmra “c” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shogërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..

III.1.4. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimve” pika 4, gërma “a” të Vendimit Nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

*“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse ...

*Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës”*

III.1.5. Në nenin 29, pika 1, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji...”*,

III.1.6. Në nenin 3.12. *“Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit”*, të Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Tatimpaguesi është i detyruar të dorëzojë, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, formularin e deklaramit të tatimit mbi fitimin sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ky formular plotësohet në përputhje me shënimet sqaruese të dhëna mbrapa tij. Po kështu, ai dorëzon në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe raportin e ekspertit të autorizuar të shoqërisë (kur ky raport kërkohet nga ligji apo aktet nënligjore)”.*

III.1.7. Ndërsa neni 41, gërma c) e Ligjit nr. 10 091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur në mbyllje të periudhës kontabël tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 40 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 30 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.*

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat,

në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.9. Referuar sa më sipër KPP gjykon se nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar nga operatori ekonomik “Adel Co” shpk, K.P.P konstaton se ky operator ekonomik ka dorëzuar - *Shkresën nr. 40943/1 prot, datë 16.08.2017, nga Drejtoria e Shërbimit dhe Rregjistrimit të Tatimpaguesve “Konfirmim Bilanci 2016”; - Raport Auditi për bilancin e vitit 2016; - Raport Auditi për bilancin e vitit 2107 Gjithashtu, KPP konstaton se vetë autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit tek “Kriteret e Vecanta për Kualifikim” pika 2.2.1, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka parashikuar detyrimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi dorëzimin e dokumentacionit kopje të certifikuara të bilanceve te viteve 2016, 2017 të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse. Nga sa më sipër sipërcituar rezulton se në kushtet kur, procedura e prokurimit objekt shqyrtimi është zhvilluar në datën 07.05.2018, e thënë ndryshe afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar nga autoriteti kontraktor sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat standarte të tenderit ka qënë data 07.05.2018, e për pasojë referuar dispozitave ligjore të mësipërcituara data për depozitimin e bilanceve pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore për vitin parardhës 2017 ka qënë data 31.03.2018, çka do të thotë se operatori ekonomik ankimues ka patur kohën e duhur për të plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për depozitimin e bilancit të vitit 2017, Komisioni gjykon se, kërkesa e autoritetit kontraktor se *Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve te viteve 2016, 2017 të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatës*, legjitimohet plotësisht, pasi procedura së prokurimit është zhvilluar më datë 07. Maj. 2018, ndaj dhe pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron pasi referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit ka patur në dispozicion kohën e duhur për të vërtetuar se e përmbush kriterin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me paraqitjen e bilancin e vitit 2017. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Adel Co” me anë të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin elektronik të prokurimeve nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me paraqitjen e bilancit të vitit 2017 nga administrate tatimore. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues “Adel Co” shpk me dokumentacionin e paraqitur nuk dëshmon se plotëson kapacitetin ekonomik dhe financiar për realizimin e shërbimit objekt prokurimi.*

Sa më sipër, pretendimi operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “[...]Përsa i përket pikës së dytë se: “Nuk plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në DST pasi nuk ka vërtetuar

pasjen e minimumi nje maldne shtypi me format 50x70 cm, duke mos shoqeruar kontraten e qera marrjes me faturen e blerjes/ faturen e zhdoganimit te makinerise, ku te percaktohet qarte lloji i saj. Sqarojme se ne kontraten e qeramarrjes nuk eshte percaktuar qarte lloji i makinerise (modeli) dhe as ne faturen e zhdoganimit nuk percaktohet qarte as lloji as formati i makinerise (shenuar me shkrim dore formati 70x100)”. Persa i perket pikes se trete, per kontraten e qeramarrjes, ju bejme me dije se kjo kontrate ka te gjitha specifikimet e nevojshme, te cilat jane shenuar edhe ne kontrate edhe ne dokumentin e zhdoganimit. - Makineri shtypi; - Format 70x 100; - 5 ngjyra; Gjithashtu edhe ne dokumentin e zhdoganimit eshte percaktuar “makineri printimi se bashku me pjeset e saj”. Me poshte eshte shkruar nr. i shasisë dhe deklaruesi ka shkruar “ mak. 5 C”, per te specifikuar makinen me shkrim dore tek pjesa e deklarates. Ne dokumentat e zhdoganimit nuk eshte domosdoshmeri qe te shkruhet specifikisht emri i makinerise. Ne mendojme se ky kriter behet i tepert dhe diskriminues pasi percakton ne menyre taksative menyren sesi duhet te provoje nje operator ekonomik potencial per te marre pjese ne nje procedure prokurimi. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se

III.2.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Vecanta për Kualifikim” pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të ketë:

- Minimumi një makinë shtypi me format 50X70,
- Minimumi një makinë qepëse,
- Minimumi një makinë telefoni

Për të vertetuar këtë pike operatori ofertues duhet të paraqesë:

- ✓ Në rast se makineritë janë në pronësi të tij, faturën e blerjes ku të përcaktohet qartë lloji i makinerisë ose faturën e zhdoganimit e të makinerisë ku të përcaktohet qartë lloji i saj.
- ✓ Në rast se makineritë janë marrë me qira të paraqitet akti i qiramarrjes shoqëruar me faturën e blerjes ku të përcaktohet qartë lloji i makinerisë ose faturën e zhdoganimit e të makinerisë ku të përcaktohet qartë lloji i saj të qiradhënësit.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Qiraje, me Nr. 2309 Rep, Nr. 657 Kol, datë 04.05.2018, lidhur pranë një noteri publik, me objekt dhënien me qera “Makinë shtypi formati 70\*100 cm, 5 ngjyra”, bashkalidhur ekstrakte QKB, ID dhe akti zhdoganimit (në të cilin nuk specifikohet lloji i makinës por e shkruar me dorë 70\*100 5 color).
- Faturë Tatimore Shitje nr. 82, datë 04.05.2015.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1.Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe

*besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

III.2.4. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.2.5. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. [...]”

III.2.6. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.7. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit, kapaciteti teknik të përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar një makineri shtypi me format 50\*70. Në kushtet kur kontrata e lidhur ndërmjet shoqërisë “Adel Co” shpk dhe “Ilar” shpk qoftë në objektin e kontratës qoftë dhe aktin e zhdoganimit bashkalidhur kontratës nuk arrin të vërtetojë së disponon makinerinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për realizimin me sukses të kësaj kontrate, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Adel Co” nuk përmbush kriterin lidhur me makinerinë e shtypit 50\*70 të kërkuara për këtë procedurë prokurimi pasi nuk provon se disponon në përputhje me ligjin këtë makineri shtypi sikundër kërkohet në kriterin e vecantë të kualifikimit. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k. nuk ka dorëzuar dokumentacion në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe rrjedhimisht nuk edhe kriterin për kualifikim për makinerinë e shtypit me format 50\*70 për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron.

III.3. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Interlogistic*” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

II.3.1. Në datën 12.04.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-62014-04-11-2018, me objekt: *Loti I “Blerje dokumentacioni shkollor (regjistra, amza, deftesa, certifikata, pulla me helogram) për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”*, me fond limit 7,933,459 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

III.3.2 . Në datën 07.05.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

III.3.3. Në datën 21.05.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

|    |                        |                  |              |
|----|------------------------|------------------|--------------|
| 1. | “Ekspo Sistem”         | pa dokumentacion | skualifikuar |
| 2. | “ALB Tipografia”       | 6,187,900        | skualifikuar |
| 3. | “Adel Co”              | 6,408,206.35     | skualifikuar |
| 4. | “Interlogistic”        | 6,438,943.30     | skualifikuar |
| 5. | “Kristalina-KH”        | 6,769,998        | kualifikuar  |
| 6. | “Shtypshkronja Morava” | 7,220,819        | kualifikuar  |
| 7. | “Albdesign PSP”        | 7,250,914        | skualifikuar |
| 8. | “Rama Graf”            | 7,764,105        | skualifikuar |
| 9. | “Dynamic X”            | 7,796,200        | skualifikuar |

III.3.4. Në datën 21.05.2018, operatori ekonomik “*Interlogistic*” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen se:

*“1) Nuk plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.3 të kriterëve të vecanta për kualifikim, të Shtojcës 9 të DST, pasi ofertuesi nuk ka paraqitur Vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore për muajt tetor 2017 - mars 2018, duke mos vërtetuar se ka të punësuar minimumi 4 (katër) punonjës të siguruar për këtë muaj”.*

II.3.5. Në datën 22.05.2018, operatori ekonomik “*Interlogistic*” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit.

II.3.6. Nëpërmjet shkresës nr. 526/2 prot., datë 14.04.2018, protokolluar me tonën me nr. 1081/2 datë 19.06.2018, me objekt “*Dërgim dokumentacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, në të



cilën konstatohet se më datën 28.05.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 526/1 prot i ka kthyer përgjigje palës ankimuese duke vendosur pranimin pjesërishtë të ankesës.

III.3.7. Në datën 13.06.2018 operatori ekonomik ankimues “*Interlogistic*” shpk, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit mësipërcituar.

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të Ligjit Nr.9643, dt.20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar:

*1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*

*1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.*

*2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*

*5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.*

*6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.*

III.3.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, konstatohet se ankesa e operatorit ekonomik ankimues “*Interlogistic*” shpk është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datën 22.05.2018, referuar aktit administrativ kthim përgjigje me nr. 526/1 Prot, datë 28.05.2018.

Referuar Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet se; “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit afatit kohor për të marrë përgjigje nga autoriteti kontraktor, ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, operatori ekonomik ankimues nuk e ka ezauruar ankimin administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda afatit të parashikuar në nenin.63, pika.6, të L.P.P-së, pasi ankimi i dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga operatori ekonomik ankimues më datë 13.06.2018 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankimim pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit afatit kohor për të marrë përgjigje nga autoriteti kontraktor, ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Për këtë arsye, ankesa e paraqitur prej operatorit ekonomik ankimues është pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63, pika.6, të L.P.P.-së, duke mos u legjitimuar *ratione temporis* në dorëzimin e ankesës pranë KPP-së.

Në nenin 82, pika.1, të Ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSh*” parashikohet se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

Sa më sipër, KPP gjykon se me anë të dokumentacionit të dorëzuar si edhe parashtrimeve para Komisionit të Prokurimit Publik, ankimuesi vetëm parashtron pretendime se ka dorëzuar ankesë më datë 21.05.2018, pa e shoqëruar me prova, ndërkohë që referuar trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, KPP referuar informacionit të përcjell nga autoriteti kontraktor për shqyrtimin e ankesës, konstaton se ankesa është pranuar nga autoriteti kontraktor më datë 22.05.2018, dhe aktit administrativ “*kthim përgjigje*” operatorit ekonomik ankimues mban nr. 526/1 Prot, datë 28.05.2018.

Referuar sa më sipër, KPP gjykon se nuk mjafton vetëm pohimi i operatorit ekonomik ankimues, pohime të cilat ankimuesi nuk i provon me asnjë dokument bashkalidhur ankesës. KPP konstaton se nuk ka provë tjetër për tu referuar mbi marrjen dijani të trajtimit të ankesës së paraqitur pranë autoritetit kontraktor, përveç shkresës së autoritetit kontraktor mbi shqyrtimin e ankesës ku përcaktohet se ankesa është protokolluar në datën 22.05.2018, ndaj për këtë arsye përllogaritjen e afateve, KPP e bën duke filluar nga data e protokollimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor, e vërtetuar kjo nga akti i autoritetit kontraktor mbi shqyrtimin e ankesës që mban datën 28.05.2018, si edhe vetë akti i ankesës dhe akti i kthim përgjigjes i paraqitur nga autoriteti kontraktor si fakt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.3.10. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “*Interlogistic*” shpk nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “*elementet e domosdoshëm të ankesës*” që, referuar nenit 23, pikës 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të*

*Prokurimit Publik*” i ndryshuar, përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.3.11. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” shpk për procedurën e prokurimit *Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-62014-04-11-2018, me objekt: *Loti I “Blerje dokumentacioni shkollor (regjistra, amza, deftesa, certifikata, pulla me helogram) për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”*, me fond limit 7,933,459 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” shpk, pwr procedura prokurimit objekt ankimi.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1081 Protokoli, Datë 11.06.2018**

**Nr. 1111 Protokoli, Datë 13.06.2018**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**